



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 26.04.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTET:
“STRUKTURA SHËRBIMI NË STACIONET E PLAZHIT”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKITË: POGRADEC, SHKODËR, LEZHË, DURRËS,
KAVAJË, RROGOZHINË, DIVJAKË, FIER, VLORË, HIMARË, SARANDË DHE
STRUKTURA SHËRBIMI BRENDA VIJËS BREGDETARE TË BASHKIVE DURRËS
DHE KAVAJË

Në mbështetje të Nenit 28, pika 1, dhe 41, pika 1/1, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 19, pika 3, shkronja “ç”, të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.23, datë 28.02.2020 “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda Zonës së Brezit Bregdetar”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejeve të Ndërtimit për: “401 struktura shërbimi në stacionet e plazhit, me vendndodhje në Bashkitë: Pogradec, Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë” dhe “6 struktura shërbimi brenda vijës bregdetare të Bashkive Durrës dhe Kavajë”.
2. Harta e vendndodhjes së 401 strukturave të shërbimit në stacionet e plazhit dhe 6 strukturave të shërbimit brenda vijës bregdetare, sipas territorit administrativ të secilës bashki, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit, të shoqëruara nga projekti arkitektonik, i jepen subjekteve zhvilluese veçmas për secilën strukturë shërbimi në stacionin e plazhit, vetëm pas depozitimit të kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, të nënshkruara mes subjekteve dhe NJVV-ve përkatëse.
4. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit, të shoqëruara nga projekti arkitektonik, i jepen subjekteve zhvilluese veçmas për secilën strukturë shërbimi brenda vijës bregdetare, vetëm pas:

- a) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Durrës dhe Kavajë.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

